



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-060/01-0036217/26
Data 24.08.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Në mbështetje të Statutit të Komunës së Skenderajt si dhe nenit 9, pika 1/4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së, për KKSBB-së dhe nenit 7.3 të ligjit Nr. 04/L-76 për Policinë; Kryetari i Komunës

THËRRET

Mbledhjen e katërt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2026, e cila do të mbahet më **31/08/2026, ditë e hënë**, duke filluar nga ora **13:30**, në sallën e Bordit të Drejtorëve në ndërtesën e komunës.

Për këtë mbledhje propozon këtë :


REND DITE

- Raport pune për periudhën 6 mujore të KKSBB-së;
- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë;
- Diskutim për fillimin e vitit të ri shkollor;
- Diskutim rreth parandalimit të dukurive negative tek të rinjtë;
- Të ndryshme.

Kryetari i Komunës


z.Sami Lushaku





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Ekstrakt nga proceverbali i mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Datë: 26.06.2026

Vendi: Salla e Bordit të Drejtorëve, në ndërtesën e Komunës

Të pranishëm në këtë mbledhje:

Nënkryetari i Komunës Fadil Nura dhe anëtarët e KKSBB-së: Faton Kajtazi (Policia e Kosovës), Kastriot Duraku (DKA), Arber Geci (DSHP), Fatmir Balaj(ZKK), Arsim Haziraj (OJQ-Handikos), Qefsere Dautaj-Uka(ZBGJ), Valon Haliti (DI), Ibrahim Hoti (KBI), Arlind Sahiti (FSK), Gordana Tomiq (KZZ), Sefadin Radonqiq (PKB).

Në këtë mbledhje u diskutuan këto pika:

1. Vlerësimi i situatës së sigurisë para sezonit veror
2. Diskutim mbi parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës
3. Diskutim rreth përgatitjes për pritje të bashkatdhetarëve
4. Siguria në komunikacion dhe masat për parandalimin e aksidenteve
5. Diskutim rreth mbarëvajtjes të sezonës së korrje-shirjeve
6. Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike
7. Diskutim rreth çështjeve të sigurisë
8. Parandalimi i dhunës në familje
9. Të ndryshme

Nënkryetari - Fadil Nura: fjala përshëndetëse. Po fillojmë më rendin e ditës, a ka dikush ndonjë vërejtje apo shkojmë me miratim, kush është për, a ka kundër, abstenim jo, atëherë vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **Vlerësimi i situatës së sigurisë para sezonit veror**, ja kaloj fjalën përfaqësuesit të Policisë Faton Kajtazi.

Faton Kajtazi: fjala përshëndetëse. Tash ka fillu sezona verore, vijnë mërgimtarë dhe shtohet fluksi, frekuentimi. I kemi gati planet operative në të gjitha fushat e komunikacionit, ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Jemi gati në bashkëpunim me institucionet e sigurisë. Deri tani të aksidentet janë 31 aksidente me lëndime dhe 31 me dëme, përgjithësi aksidente të lehta, janë shtuar edhe dënimet me gjoba, por në përgjithësi janë raste të natyrës së lehtë, në krahasim me komunat e tjera jemi shumë mirë. Për sezonën verore problemi është siguria në trafik, ahengjet e ndryshme, zjarret fushore, mirëpo planet i kemi të gaqshme.

Nënkryetari - Fadil Nura: faleminderit për diskutim, e hapi debatin për këtë pikë, a e don dikush fjalën? Mirë, atëherë me konstatimin që të fuqizohet edhe më shumë bashkëpunimi sidomos në këtë rast me Inspeksionin edhe pse e di që bashkëpunimi është edhe me akterët tjerë si Shërbimet Publike, Drejtorinë e Arsimit, në përgjithësi mund të konkludojmë bashkarisht se situata e sigurisë është e qetë.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: **Diskutim mbi parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës**. A e don fjalën dikush?

Faton Kajtazi: duke u nisur nga hera e kaluar, zjarret që janë tek ne, me qenë numër me i madh, me angazhu punëtor më shumë, shumica e këtyre zjarreve kontrollohen me lehtë.

Nënkryetari - Fadil Nura: Ne bashkarisht, me qenë të koordinuar më policinë që përveç intervenimeve është e rëndësishme edhe për masat parandaluese sepse edhe temperaturat do të jenë të larta.

Arber Geci: paisjet e zjarrëfiksive, shumica janë servisu edhe pse janë të vjetra ka pak telashe. Në një takim me komandantin e policisë dhe përgjegjës regjional Vushtri e Mitrovicë janë duke bërë një plan në Bashkësi Lokale, që t'i bëjmë ekipe vullnetare 5,6,10,20 sado persona që bashkangjiten, sepse numri i zjarrfikësve është i vogël gjithashtu me pasë pika për furnizim me ujë, në mënyrë që në secilën bashkësi lokale të kemi ndonjë pikë për furnizim me ujë dhe me shu zjarrin.

Nënkryetari - Fadil Nura: me i lokalizu vendet ku furnizohen më ujë zjarrfikësit në fshatra, bashkëpunimi është një masë parandaluese sepse jemi sfiduar sidomos në vitin e kaluar, sido që te jetë ajo që ka rëndësi është që zjarrfikësit të jenë në nivelin e duhur.

Atëherë kalojmë në pikën e radhës: **Diskutim rreth përgatitjes për pritje të bashkatdhetarëve** këtë pikë e kemi standard çdo vit sepse dyfishohet numri i banorëve, dyfishohet edhe nevoja për ofrimin e shërbimeve. Ne si komunë përmes administratës në shërbimet administrative për

dokumentacionet e nevojshme që mos t'i lemë në pritje në sportele, pastaj muajin e bashkatdhetarë që e organizojmë në shesh, me aktivitete të ndryshme muzikore e kulturore. Ka vite që nuk kemi pasur ndonjë incident edhe pse ka pasë pjesëmarrje shumë, mirëpo telashe probleme nuk kemi pasur. Aktivitetet edhe bashkëpunimi ka me qenë si vitet e kaluara.

Faton Kajtazi: përdorimi i fishekzjarrëve pas orës 23:00, duhen masa, pastaj ora 1,2,3 e mëngjesit është mirë që të njoftohen që t'i evitojnë, në bashkëpunim me drejtorinë e inspeksionit, gjithmonë në suaza ligjore, aq sa lejohet me ligj.

Nënkryetari - Fadil Nura: a ka dikush tjetër diçka me shtu për këtë pikë të rendit të ditës?

Atëherë kalojmë në pikën e radhës: **Siguria në komunikacion dhe masat për parandalimin e aksidenteve**

Kastriot Duraku: e kemi pasur një vendim nga komuna që ndalon motorrat elektrik në sheshin Adem Jashari, të njëjtën e kemi bërë edhe në shkollë, mendoj që është një vendim i mirë dhe i nevojshëm dhe i ikim aksidenteve.

Faton Kajtazi: për shesh është edhe shenja e komunikacionit që e ndalon qarkullimin për këto mjete. Për një kohë të shkurtër janë 54 gjoba që janë shqiptuar nga policia për motoçikleta, trotineta, katërrotësh, 26 janë konfisku, mirëpo në Mitrovicë janë 192 gjoba, Vushtrria 182 gjoba, pra janë më shumë me gjoba, ne më shumë më vërejtje, mirëpo në sezonën e verës duhet t'i shtrengojmë masat në këtë drejtim.

Valon Haliti: ka vendim që ndalohet qarkullimi i çdo lloj mjeti elektrik dhe biçikletave.

Nënkryetari - Fadil Nura: mirë kalojmë në pikën e radhës: **Diskutim rreth mbarëvajtjes të sezonës së korrje-shirjeve**

Si përgjegjësi e Komunës është ku Kryetari i Komunës e cakton shtabin e korrje-shirjeve në bazë të legjislacionit në fuqi i udhëhequr nga Drejtori i Bujqësisë, i cili komunikon me bujqit dhe me kompanierët, përcaktimi i çmimit. Një informat drejtori i bujqësisë.

Sabit Ferizi: fjala përshëndetësë, meqenëse jemi në prag të kohës së korrje-shirjes, ne si drejtori kemi filluar përgatitjet me vizitat të autokompanieret më qëllim që ata të jenë sa më të përgatitur. Për informacion kemi të mbjellur gjithsej 6750 ha grurë, 140 ha me elb, 10 elb dhe 5 ha bimë foragjere. Zyrtarisht kjo fushatë e korrje shirjeve fillon nga fillimi i korrikut në bashkësinë lokale të Turiqecit ku vegjetacioni është më i shpejtuar, ndërsa nga data 10 kjo operativ do të filloj në të gjithë komunën tonë, do të angazhohen mbi 100 autokombaja dhe në bazë të vlerësimit tonë kjo operativ do të kryhet brenda 15-20 ditësh varësisht nga kushtet klimatike. Çmimi vjen rekomandimi nga Ministria e Bujqësisë dhe përcakton edhe çmimin për ha.

Kërkesën për themelimin e shtabit të korrje-shirjeve e kemi bërë, ku do të përfshihet agronom të drejtorisë tonë dhe nga Shërbimet Publike, brenda javës së ardhme do të krijohet ky komision. Të mbjellurat janë të ngjashme me ato të vitit të kaluar, rendimenti pritet të jetë i mirë.

Nënkryetari - Fadil Nura: a ka dikush ndonjë pyetje ndonjë këshillë, nëse jo kalojmë të pika tjetër: **Rujatja e rendit dhe qetësisë publike** lidhet kryesisht me sigurinë në përgjithësi

Faton Kajtazi: Ankesat po janë më shumë për shkak të zhurmave gjatë natës, me pasë mundësi në bashkëpunim me inspektoratin me u njoftu të gjithë që për hirë të mërgatës lejohet deri në orën 23:00 ose 00:00, në mënyrë që të gjejmë një mirëkuptim. Shqetësim e shumë sfida është parandalimi i përdorimit të narkotikëve në gjithë Kosovën jo vetëm tek në. Duhet të përmirësohet pjesa e kamerave, mirëmbajtja. Por bashkëpunim kemi.

Nënkryetari - Fadil Nura: mbledhjes i bashkangjitet edhe Ibrahim Hoti. E di që për pjesën e narkotikëve edhe Bashkësia Islame e jep kontributin e vet për problemet shqetësuese në nivel vendi por fatkeqësisht edhe në Skendraj.

Ibrahim Hoti fjala përshëndetëse, do të ishte mirë të kemi ndonjë rekomandim për ligjeratë rreth këtij problemi, që nëpër të gjitha xhamiat të trajtohet pjesa e narkotikëve të fëmijët, në mënyrë që të meret si formë parandaluese apo masë preventive, besoj që do të ketë ndikim.

Nënkryetari - Fadil Nura a jeni për që të jepët si rekomandim Bashkësisë Islame me fut si ligjeratë çështjen e narkotikëve tek adoleshentët, po konstatoj që me shumicë pajtohem.

Pika e 7: Diskutim rreth çështjeve të sigurisë: Atëherë mendoj që si pikë u konsumu në pikat e mëhershme, është afërsisht e njëjtë. Kalojmë të pika e radhës: **Parandalimi i dhunës në familje** e kemi zyrtarën këtu që ia jepim fjalën.

Qefsere Dautaj, fjala përshëndetëse. Si koordinatore e Mekanizmit Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje, në këtë vit kemi mbajtur dy takime të Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje, takimin e fundit e kemi mbajtur në bashkëpunim me OSBE ku kemi dhënë disa rekomandime: mbështetje me disa fondacione, me rrit buxhetin nga niveli qendror, mundësi më të mëdha për risocializimin e viktimave të dhunës në familje. Gjatë këtij viti i kemi pasur 24 raste të raportuara të dhunës në familje ku 4 prej tyre i kemi pasur në strehimore në Mitrovicë. Vitin e kaluar kanë qenë 52 raste të raportuara gjatë gjithë vitit, ndërsa deri tash 24 raste.

Ne si Zyre për Barazi Gjimore vazhdimisht mbajmë fushata vetëdijësuese për parandalimin e dhunës në familje dhe raportimit të tyre, këto fushata i mbajmë në shkolla, me gratë në zonat rurale dhe gjithë komunitetin, kemi hartuar edhe fletushka, postera për vetëdijësimin dhe informimin e mekanizmave mbrojtës kundër dhunës në familje. Deri në fund të vitit i mbajmë 6 takime të Mekanizmit Koordinues.

Në bashkëpunim dhe mbështetje të OSBE kemi bërë kërkesë që ta bëjmë Planin Lokal të Veprimit të Mekanizmit Kundër Dhunës që është plan që kërkohet sipas ligjit dhe duhet të miratohet në

Kuvend. I kemi edhe disa pika të Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore të cilin e kemi miratuar në shtator të vitit të kaluar, që na ndihmojnë, por na duhet vetëm Plani Lokal për Mekanizmin Kundër Dhunës.

Si Zyre për Barazi Gjinore jemi në vazhdimësi më fushata vetëdijesuese.

Nënkryetari - Fadil Nura a ka dikush sa i përket parandalimit të dhunës në familje? Nëse jo, vazhdojmë me pikën e radhës: **Të ndryshme**

Ibrahim Hoti, të shërbimi i varrimit që është përmes Këshillit të Bashkësisë Islamë dhe Komunës, në datën 10 korrik përfundon marrëveshja, duhet me vazhdu, mirëpo problemi është të furnitorët ku ne i marim me shumicë mjetet e shërbimit të varrimit, i kanë shtrenjtuar të gjitha, dmth nuk mbet asgjë si fitim përveç mëditjes për shërbimin e pastrimit si hoxhollar dhe hoxhenica, sikur të ishte e mundshme që nga 280-290 për rast të jetë të paktën 330 do të ishte mirë, e kish lehtësu situatën, sepse jemi nga të gjitha Komunitet Bashkësi Islame në Skenderaj shërbimet e varrimit i ka të gjitha 24/7, muajin e kaluar QTA na e ka dhuru një kombi për shërbimet e varrimit. Përveç kësaj, regjistrimin e automjeteve, servisimin i kryejm vet. Por sa i përket shërbimit të varrimit si Bashkësi Islame jemi mirë edhe pse me vështirësi.

Nënkryetari - Fadil Nura ne si Komunë duhet me analizu me Drejtorinë e Financave është koha e përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe mundemi me parashiku, vullneti nuk mungon, mirëpo brenda mundësive do e diskutojmë me ardhë të 310-330, mirëpo duhet me i pa sa i kemi mundesitë. Do e diskutojmë edhe në takimin e bordit me drejtorin.

Ibrahim Hoti, një problem e kemi me kanalizimin në Polac, bllokimi i kanalizimit, që 4 vite, afër xhamisë.

Nënkryetari - Fadil Nura do e shohim se bashku me drejtorin e urbanizmit se çka mundemi me ba me zgjidhë si problem.

Dikush tjetër a ka diçka? Nëse jo, e mbylli këtë takim për këtë muaj dhe shihemi në takimin e radhës.

Faleminderit shumë.

Procesmbajtës/e:

